REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 109/20
Datë/Datum. 18.02.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **"KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT"**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **622-19-4853-2-1-1**

Sa i përket tenderit për ***"Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit në Komunën e Prizrenit"***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ALFA.I SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ibrahim Rugova pn.

(Adresa)

Lipjan — *(Vendi)*

14 000 — *(Kodi postar)*

00383 38 606 706 — *(Numri Telefonit)*

N/A — *(Numri i Faks-it)*

Lulzim JAHAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@alfa-i.com

(Adresa elektronike)

14.02.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

Limited Liability Company alfa.i Trade Construction

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 05.07.2019
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 14.08.2019 14:00
Procesverbali i hapjes: 14.08.2019 14:00
Data e njoftimit per: Leter standarde per tenderuesin e pasukseshshem: 20.08.2019
Njoftimi mbi vendimin e AK 1: 20.08.2019
Data e kerkeses per qasje ne dokumente: 20.08.2019
Data e qasjes: 21.08.2019
Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët
Kerkesa per rishqyrtim 1: 26.08.2019
Vendimi i kerkeses per rishqyrtim: 29.08.2019
Njoftimi mbi vendimin e AK 2: 28.10.2019
Data e kerkeses per qasje ne dokumente: 28.10.2019
Data e qasjes: 29.10.2019
Kerkesa per rishqyrtim 2: 04.11.2019
Vendimi i kerkeses per rishqyrtim 2: 07.11.2019
Ankesa OSHP 2: 15.11.2019
Njoftimi mbi vendimin e AK 3: 28.01.2020
Kerkesa per qasje ne dokumente: 28.01.2020

Limited Liability Company alfa-i Construction - Engineering & Trade

Qasja ne dokumente: 30.01.2020 Kerkesa per rishqyrtim 3: 03.02.2020 Vendimi i kerkeses per rishqyrtim 3: 06.02.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Gjithcka ka shkuar mire ne hapjen e tendereve.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 6 i LPP-së** **Neni 7 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 64 i LPP-së** **Neni 68 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së** **Nenin nr. 8.1 & 8.2 i FDT-së** **Nenin nr. 9.1 & 9.2 i FDT-së** **Vendimi i OSHP-së Nr. 574/19 të dt. 23.10.2019** **Vendimi i OSHP-së Nr.; 809/19 te datës 13/01/2020**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

Limited Liability Company alfa.i Construction Enginering & Trade

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne me dt. 28.01.2020 në platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku për kontratë kanë propozuar konzorciumin FORTESA O.P; FORTESA SH.P.K; DIARKO SH.P.K
Si fillim ju sqarojmë se AK-ja nuk e ka respektuar vendimin 574/19 të dt. 23.10.2019 të panelit shqyrtues, ku na është aprovuar ankesa jonë si pjesërisht e bazuar dhe është marrë vendim të anulohet vendimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.
Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe vendimin e fundit të OSHP-së nr.809/19 të dt.13.01.2020 ku është kërkuar që të kërkohen sqarime shtesë për kontrata, edhe pse AK-ja ka kërkuar sqarime për kontrata mirëpo nuk i ka marr parasysh fare sqarimet tona, madje AK-ja në të njëjtën ditë që ne kemi dërguar sqarimet AK ka përpiluar raportin e vleresimit, që na jep të kuptojmë që AK-ja as gjasa teorike nuk ka pasur për të analizuar të gjithë atë dokumentacion që ne kemi dërguar i cili ka qen mjaft voluminoz.
Ne me dt. 21.08.2019 kemi pasur qasje në dokumentet e të gjithë operatorëve ekonomik ku kemi marrë dokumentacionet e tyre.

Fillimisht ju njoftojmë që ne jemi eliminuar për arsye se kinse nuk i plotësojmë kriteret e dosjes së tenderit specifikisht:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

- **Kërkesa 1.Kontratat-Referencat të realizuara në tri vitet e fundit për lëminë e (mirëmbajtjes kanalizimeve, ujësjellësve dhe pusetave) (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 2.000.000,00 €.Duke u bazuar në dosjen e tenderit përkatësisht kushtet dhe kriteret ku ceket se si referencë duhet të merren vetëm rehabilitimet e kanalizimeve, ujësjellësve dhe kapakëve të pusetave, komisioni ka ardh në përfundim se referencat adekuate të natyrës së kontratës ky konzorcium ka gjithsejtë:756,492.59 euro.**

Ju njoftojmë që nuk pajtohemi me vendimin e AK-së për arsye se ne e plotësojmë kërkesën e lartpërmendur.
Autoriteti kontraktues nuk është serioz fare me këto vlerësime të tyre, sepse në herën kaluar kur e kanë vlerësuar tenderin na kanë thënë që totali i kontratave të prezantuara nga ne arrin vlerën 1.552.436,00 EURO. Prandaj po shihet qartë tendenca e AK-së për të na eliminuar neve me çdo kusht. AK-ja nuk i ka llogaritur kontratat e poshtëshënuara të cilat kalojne 2 apo 3 fishin e vleres se kerkuar ne DT.

1. Kontrata e dorëzuar nga ne e titulluar:
Completation of works under Muninfra 3 – Lot 3 – Group 1 me vlerë totale
299.919,00 EURO – (për vërtetësi, ju lutem qe ti shikoni sqarimet qe u'a kemi derguar Autoritetit Kontraktues me date 24.01.2020 ku ne te jane paramasa/boq ku

Limited Liability Company alfa.i Construction - Engineering & Trade

mund te verifikohen punet e ngjajshme pozicion per pozicioni dhe ta vertetoni se kjo kontrate eshte kontrate adekuate dhe se ploteson kerkesen DT).
Completation of works under Muninfra 3 – Lot 3 – Group 2 me vlerë totale
218.152,00 EURO – (për vërtetësi, ju lutem qe ti shikoni sqarimet qe u'a kemi derguar Autoritetit Kontraktues me date 24.01.2020 ku ne te jane paramasa/boq ku mund te verifikohen punet e ngjajshme pozicion per pozicioni dhe ta vertetoni se kjo kontrate eshte kontrate adekuate dhe se ploteson kerkesen DT).
Completation of works under Muninfra 3 – Lot 3 – Group 3 me vlerë totale
271.260,00 EURO – (për vërtetësi, ju lutem qe ti shikoni sqarimet qe u'a kemi derguar Autoritetit Kontraktues me date 24.01.2020 ku ne te jane paramasa/boq ku mund te verifikohen punet e ngjajshme pozicion per pozicioni dhe ta vertetoni se kjo kontrate eshte kontrate adekuate dhe se ploteson kerkesen DT).

2. Kontrata e dorëzuar nga ne e titulluar:
Water Supply and Sewerage Prishtina II – Installation of Water Resources Measures and Replacement Distribution Network in Fushë Kosovo (1&2) Area
Furnizimi i ujësjellësit dhe kanalizimit Prishtina II – Instalimi i masave mbrojtëse te burimit te ujit dhe rehabilitimi i rrjetit shpërndarës ne Fushë Kosovë, me vlerë totale 3.563.192,60 EURO + punët shtesë në vlerë prej 219.230,00 EURO = totali i kontratës 3.782422,00 EURO - kjo është kontratë adekuate ku ka pasur rehabilitim të rrjetit të ujësjellësit, për lehtësimin tuaj e keni të hijezuar pjesën ku shihet qartë natyra e punës pra rehabilitim, por kjo nuk është marrë parasysh fare nga ana e AK, (gjeni të bashkangjitur prapë)

Kontrata e dorëzuar nga ne e titulluar:
Rehabilitimi i sistemit të ujësjellësit në Mitrovicë të Jugut – KSV/018-17-130 në vlerësimin e tyre AK-ja ka thënë që vlera e kësaj kontrate është **446.141,34 EURO** ju lutem të shikohet e tërë kontrata me të gjitha amandamentet, shikojeni **Amandamentin 4** ku tregohet vlera e kontratës pas punëve shtesë që është **637.929,77 EURO (gjeni të bashkangjitur Amandamentin 4, i njëjti ka qenë edhe në dosje të tenderit).**

Gjithashtu gjatë "vlerësimit" të AK-së është thënë se kontrata **"Ndërtimi i 15 skemave të ujësjellësit në Regjionin e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës"** është nënshkruar më 30 qershor në vitin 2014 dhe është përfunduar me 12 dhjetor 2017, që është brenda afateve kohore, por edhe pse shihet shumë qartë data e nënshkrimit të kontratës AK thot që kontrata është nënshkruar në vitin 2013 dhe per kontraten e njejte thote se nuk eshte adekuate. (ju lutem shikoni te bashkangjitura VARIATION ORDER 3 dhe INSRTUCTION 05 ku shihen punet e rehabilitimit)

AK-ja ka këkruar sqarime nga ne si në vijim "Komisioni rekomandon qe OE *Alfa-I Shpk& Qemal Krasniqi B.I te sjell dëshmi sipas listës se dorëzuar ne ofertën tuaj për referenca dhe kontrata qe dëshmojnë vlerën e punës dhe natyrën e tyre apo procesverbalet e pranimet te punëve .Dokumentet qe sillen për natyrën e kontratës te jen te specifikuara për secilin pozicion. Nëse dokumentet sillen vetëm ne shume totale nuk do te merren parasysh.*
Këto dokumente te jen te skanuara nga origjinale ose te noterizuara
(vetëm për referenca te natyrës se kontratës- Rehabilitimi i ujësjellësve dhe kanalizimeve dhe projekteve te ngjashme).
Kërkesa jon bazohet ne baze te vendimit te OSHP-se me nr.; 809/19 te datës 13/01/2020.

Ne me dt.24.01.2020 kemi dërguar sqarimet në detaje për kontrata tona por sqarimet tona

Limited Liability Company alfa-i Construction - Enginering - Trade

as nuk jane marrë parasysh nga AK, kjo shihet qartë për arsye se AK me datë 27.01.2020 ka hapur emailin e sqarimeve tona, kurse në të njejtën datë pra 27.01.2020 kanë perpiluar raportin e vlerësimit, kjo shihet qartë që as që jane shikuar sqarimet që i'a kemi dërguar por e AK ka përpiluar raportin e vleresimit para se të pranojne sqarimet tona, kështu duke mos respektuar vendimin e OSHP-se me nr.; 809/19 te datës 13/01/2020.

"Sqarimi jonë ka qenë si në vijimë:
Edhe nëse shikohen punët pozicion për pozicioni ne jo qe arrijmë vlerën e kërkuar nga AK-ja, por edhe e tejkalojmë, por se pari ju njoftojmë qe nuk pajtohemi fare me pyetjen e AK-së për arsye se një rehabilitim i kanalizimit ose rrjetit te ujësjellësit nuk mund te kryet pa pune tjera e siç janë: përgatitja e punëve, punimet e tokës, punët e betonimit te kanalit, gërmimet, zëvendësimet e gypave dhe pjesëve fazonike, testimit te punëve etj.
Pra nuk mund te shikohet vetëm pjesa specifike ku ne pozicion shkruan REHABILITIM dhe te mirret për baze ajo vlere siç ka kërkuar AK-ja për arsye se rehabilitimi pa punët përcjellëse nuk mund te kryhet, pra duhet te mblidhen te gjitha vlerat e punëve te ngjashme qe hyjnë ne kuadër te kësaj pune specifike pra rehabilitimit te një ujësjellësit apo kanalizimit.
Me poshtë gjeni kontratat e pranuara dhe kontratat kontestuese nga ana AK-së, te cilat te gjitha e kane shpjegimin e tyre dhe ato i'a dëshmojmë me dokumentet e kërkuara nga ana AK-së (kontrata, referenca BoQ etj, që të mund ti verifikoni pozicionet e punëve te ngjashme)

Nr.	Emri i projektit	Contract no:	Vlera	Komenti
1	Rehabilitation of the water supply system in Mitrovica South, Vushtrri and Skenderaj Investment Stage 2 – Part 1 – Lot 2	KSV/018*15 434	Kontrata baze: 118.223,57 EURO + Addendum 1 = 58.909,59 Vlera Totale e kontrates: 177.133,16 EURO	E pranuar nga Autoriteti Kontraktues
2	Rehabilitation of the water supply system in Skenderaj – Investment Stage 2 Part 2	KSV/018*16 468	Vlera Totale e kontrates: 209.054,50 EURO	E pranuar nga Autoriteti Kontraktues
3	Rehabilitation of the water supply system in Mitrovica South – Investment Stage 2 Part 2	KSV/018*17 130	Kontrata baze: 446.141,34 Addendum 1: 78.070,72 Addendum 2: 29.216,00 Addendum 3: 40 676,71 Addendum 4: 43.825,00 Vlera Totale e kontrates: 637 929,77 EURO	E pranuar nga Autoriteti Kontraktues
4	Zhvendosja e rrjetit kryesor te furnizues te Batllaves	616 15 215 521	158.017, 00	E pranuar nga Autoriteti Kontraktues

Limited Liability Company
alfa
Construction - Enginering & Trade

5	Meremetimi dhe Ndërtimi i Kanalizimeve	624 17 068 521	Vlera Totale e kontrates: 324.102,43 EURO	E pranuar nga Autoriteti Kontraktues
6	Rehabilitimi i kanaleve ujitjes dhe pastrimi i kanaleve kulluese	622 16 155 521	Vlera Totale e kontrates: 46.202,50 EURO	E pranuar nga Autoriteti Kontraktues
7	Water Supply and Sewerage Prishtine II – Installation of Water Resources Measures and Replacement Distribution Network in Fushe Kosovo (1&2) Area, e perkthyer ne shqip " FURNIZIMI I UJESJELLESIT DHE KANALIZIMIT PRISHTINA II – INSTALIMI I MASAVE MBROJTESE TE BURIMIT TE UJIT DHE REHABILITIMI I RRJETIT SHPERNDARES NE FUSHE KOSOVË"	Prishtine-P2-INT-WC2 (Lot 1)	Kontratë baze: 3.563.192, 60 EURO + Addendum 1: 219.230, 00 Vlera Totale e kontrates: 3.782.422,60 EURO	Kontrate kontestuese nga Autoriteti Kontraktues. Gjene sqarimin ne rreshtin e me poshtem.

Në lidhje me kontratën me nr.3 "Rehabilitation of the Water supply system in Mitrovica South – Investment Stage 2 Part 2", ju sqarojmë se kontratë është e përfunduar në tërësi dhe ka referencë pozitive, e nuk është e vërtetë se ka pranim të përkohshëm, mirëpo është në periudhën e garancionit që vazhdon pas përfundimit të punimeve. Prandaj kjo kontratë duhet të merret si valide sepse i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së.

Në lidhje me kontratën me nr.4 "Zhvendosja e rrjetit kryesor te furnizues te Batllaves, ju sqarojmë se kontrata është përfunduar në vitin 2016 ndërsa referenca është marr ne vitin 2018.

Në lidhje me kontratën e renditur në numrin 7, ju njoftojmë qe rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit ne Fushe Kosovë ka qene i ndërtuar qe me pare, ku ekziston rrjeti kryesore i ujësjellësit dhe kanalizimit.

Pas rritjes se numrit te banoreve ne atë zone atëherë është dashur rritja e kapacitetit te ujësjellësit , projekti i lartpërmendur i realizuar nga kompania jone ka qene rehabilitimi i rrjetit ekzistues te ujësjellësit ku kemi bere rritjen e kapacitetit dhe zgjerimin te tij sipas projektit kryesore për pjesën e Fushe Kosova I (ana e djathte Prishtine – Peje), ndërsa Fushe Kosova II (ana Peje – Prishtine) duke përfshire punët si:

Mbrojtjet dhe Gardhimi i prurjeve në burimet e ujit tek Liqeni i Badovcit L=960m, ndërtimi i murit mbrojtës në 11 puse në Fushë Kosovë,

Limited Liability Company

Rehabilitimi dhe instalimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Fushë Kosova 1 me gyp OD 630 HDPE L=18.7km, instalimi i 11 Hidrantëve dhe 750 kyçje ve shtëpiake në ujëmatës dhe pusetë.
Rehabilitimi dhe instalimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Fushë Kosova 2 L=18.2km OD 400 HDPE, instalimi i 12 Hidrantëve, 783 kyçjeve shtëpiake me ujëmatës dhe pusetë.
Pra projekti i lartpërmendur ka qene rehabilitimi, ashtu siç është kërkuar nga AK-ja ne dosje te tenderit, dhe kjo kontrate si e vetme e plotëson kriterin e AK-së pasi qe vlera e kësaj kontrate është 3.782.422,00 EURO.
Ju lutemi qe ta verifikoni këtë kontrate dhe nëse AK-ja nuk ka besim ne përshkrimin tone si Operatore Ekonomik atëherë e ka te drejtën edhe te dërgoj pyetje te Autoriteti Kontraktues me te dhënat si me poshtë:
Investitori: KFW/ KUR Prishtina
Personi Kontaktues: Gjelosh Vataj
Numri Kontaktues: 044-357-222

8	Completation of works under Munifra 3 – Lot 3 Group 1	17/2015-IPA 20121	Vlera e kontrates: 299.919, 00 EURO	Kontrate e kontestuar nga AK
9	Completation of works under Munifra 3 – Lot 3 Group 2	04/2015-IPA 2012	218.152,00 EURO	Kontrate e kontestuar nga AK
10	Completation of works under Munifra 3 – Lot 3 Group 2	05/2015-IPA 2012	271.260, 00 EURO	Kontrate e kontestuar nga AK

Përshkrim i projektit:
Completation of works under Munifra 3 – Lot 3 Group 1, Group 2 dhe Group 3.
Ne rajonin e Prizrenit specifikisht ne Kukë dhe Kosavë te Dragashit, ne fshatin Skivjan te Gjakovës, ne fshatin Mushtisht të Suharekës, ne Junik dhe në fshatin Medvec dhe Vrellë të Lipjanit sistemi i kanalizimit dhe ujësjellësit ka qenë ekzistues prej vitit 2012 dhe është financuar nga Komisioni Europian, por pas dëmtimeve dhe nevojës te banoreve është dashur te behet rehabilitimi i tyre.
Gjatësia ekzistuese për te gjitha rajonet e lartcekura ka qene përafërsisht 50 km dhe në to është dashur të intervenohet ne rehabilitimin e tyre.
Ky projekt ka qenë i ndarë në 3 grupe ku vlera totale e tyre është 789.331, 00 EURO.
Pra këto konsiderohen kontrata të veçanta dhe këtë mund ta vërtetoni tek numrat identifikues dhe numrat e kontratave.
Ne këtë projekt janë punuar këto pune:
Rehabilitimi i rreth 50 km te kanalizimit duke përfshirë punimet e tokës, gërmimi, mbushja, nivelim dhe ngjeshja, rehabilitimi i gypave ekzistues, furnizimi dhe instalimi i gypave te ri, punimet e betonit, rindërtimi i pusetave dhe trajtimit te ujërave te zeza, punët mekanike furnizimi dhe instalimi i paisjeve qe mungojnë dhe qe janë dëmtuara, punimet elektrike furnizimin dhe instalimin e përbërësve elektrikë të zhdukur dhe të dëmtuar dhe instalimi i sistemit SCADA, Punime të jashtme, lidhje me shërbimet publike, punët e rrethimit, rrugën hyrëse, prerja, heqja, asgjësimi i sipërfaqeve ekzistuese të asfaltit dhe betonit dhe rikthimi i tyre pas përfundimit të punimeve.

Limited Liability Company
alfa.
Construction - Engineering & Trade

Ju lutemi qe ta verifikoni këtë kontrate dhe nëse AK-ja nuk ka besim ne përshkrimin tone si Operatore Ekonomik atëherë e ka te drejtën edhe te dërgoj pyetje te Autoriteti Kontraktues me te dhënat si me poshtë:

Investitori:KomisioniEuropian
Personi Kontaktues: Christof Stock

11	Construction of 15 Water Schemes on the Regions of Shkodra, Kukes and Dibra. Ne shqip: Ndertimi i 15 skemave te ujesjellesit ne Regjionin e Shkodres, Kukesit dhe Dibres.	SUF IV-WC/ICB/2013/CW 1	5.260.132,90	E kontestuar nga Autoriteti Kontraktues Te shikohet: 1. BoQ-Paramasa 2. VARIATION ORDER 3 dhe 3. INSTUCTION 05

Të gjitha 15 skemat apo 25 fshatrat në përgjithësi kanë një ngjashmëri sa i përket komponimit të elementeve të skemave të ujësjellësit, por ndryshojnë në numër dhe madhësi të elementeve.

Elementet kryesore të skemave të ujit janë:

- Lidhja me një rrjet shpërndarës ekzistues me një dhomë
- Kaptazha e ujit të vrazhdë / si alternativë uji rrjedh nga një linjë kryesore
- Linja kryesore shpërndarëse / pika prekëse me rezervuarin
- Ndertimi i stacionit te pompave
- Thyerja e presionit / dhoma e shpërndarjes
- Komponentët e rezervuarit (rezervuari i ujit, klorinimi, thyerja e presionit dhe dhoma e shpërndarjes, dhoma e valvës së kontrollit dhe mbrojtjet)
- Gypi kryesor deri në rrjetin shpërndarës
- Lëshesat, lirimi i ajrit, dhomat e ujëmatësve
- Rrjeti shpërndarës
- Ndërtimi i 21 Rezervuareve të ujit – madhësi të ndryshme (20-75 m3)
- Instalimi i 36.6 km rrjet shpërndarës të gypave RC HDPE – diametra të ndryshëm
- Instalimi i 119.1 km Rrjet Shpërndarës të Ujësjellësit me gypa RC HDPE – diametra të ndryshëm deri OD 500
- Ndërtimi i 829 copë të Dhomave të Betonit (lëshues/zbarkues i rrjetit, valve ajrimi, thyes presioni, shpërndarje, valve kontrollit)
- Instalimi i 3770 Ujëmatësve Shtëpiak në dhomat e Ujëmatësve të Betonit

PERVEQ PROJEKTIK KRYESORE ADF (Fondi Shqipetar per Zhvillim) ka propozuar edhe rehabilitimin kanalit kryesore Sopanika. (Te shikohet Variation Order 03) dhe Rehabilitimin e rrjetit ti sanitar, kanalizimit (te shikohet INSTRUCTION 05)

Autoriteti kontraktues në vlerësimet e tyre është bazuar në tituj të aktiviteteve të prokurimit dhe të kontratave që ne i kemi ofruar, mirëpo mik duhet vlerësuar në këtë mënyrë dëshmitë për kontrata dhe referenca sepse kërkesë në FDT tek dëshmia e kërkuar

Limited Liability Company
Construction - Engineering & Trade

dokumentare ka qenë lista e projekteve të natyrës së kontratës.
Prandaj në secilin do variant, ne e tejkalojmë vlerën e kërkuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë dhe jemi ofertues i përgjegjshëm.
Krejt çka kërkojmë nga ju është të detyroni AK që ti analizoj sqarimet tona që i kemi bërë në detaje me rastin e kërkesës e AK-së për të dhënë sqarimet në lidhje me kontratat dhe referencat.
Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:
Grupi i operatoreve ekonomik nuk ka plotësuar "Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare", nenin 8.1 & 8.2 ku kërkohet qe Operatori Ekonomik si evidencë të paraqesë
Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.
Grupi i operatoreve ekonomik i propozuar për kontratë ka sjellur vetëm Deklaratat Tatimore dhe qarkullimin financiar nga banka. Por e njëjta nuk e ka përmbushur kërkesën kryesore të kërkuar në dosje të tenderit pra nuk ka sjellur **Pasqyrat e qarkullimit financiar të kompanisë,** por vetëm Deklaratat Tatimore dhe qarkullimin bankar e këto të fundit është dashur vetëm t'iu bashkëngjiten PASQYRAVE TE QARKULLIIMIT FINANCIAR (raporteve financiare, raportit te auditorit), pra nuk e plotëson kriterin kryesor tek "Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare", nenin 8.1 & 8.2.

Gjithashtu lidhur me pajisjet, kompania NTSH ''Fortesa'' e propozuar për kontratë ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë "NTSH INTEGRAL" ku në marrëveshje ceket që NTSH FORTESA do të ketë përkrahje të makinerisë nga NTSH INTEGRAL për vitet 2017,2018 dhe 2019, kurse kjo kontratë që propozohet t'i jepet NTSH FORTESA është kontratë kornizë 36 muajshe dhe nuk plotësohet kërkesa e AK-së.
Këtu shihet qartë që grupi i OE të rekomanduara për kontratë nuk i plotësojnë kriteret e makinerisë/pajisjeve dhe si e tillë nuk munden t'i kryejnë punimet për arsye se nuk do të kenë përkrahje për makineri sepse përkrahja për makineri nga NTSH INTEGRAL është deri në vitin 2019.

Ne me dt. 06.02.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka **qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa ne jemi diskriminuar, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe kemi ofruar çmim më të ulët, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka pasur parasysh vendimet e OSHP-së në lidhje me nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së sepse oferta jonë është me çmim dukshëm më të ulët se sa oferta OE të rekomanduar për kontratë **(415,332.00 euro më lirë se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë),** prandaj duhet të kursehet buxheti i Komunës me vendimet e AK-së, sepse me këtë diferencë të çmimit mund të kryhet edhe një projekt tjetër kapital në interes të

qytetarëve.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **ALFA.I SH.P.K**.
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Limited Liability Company
alfa.i
Construction - Engineering & Trade